



Asamblëtë Rinore për Zhvillimin e Komuniteteve

Përmbajtja

Hyrje

Çka është Asambleja Rinore?.....	3
Ku gjenden asambletë rinore?.....	3
Ndryshimet e rekomanduara nga asambletë rinore nga viti 2005.....	4
Projektet e viteve 2004 dhe 2005.....	10
Kampi verorë i asamblesë rinore.....	11
Si mundem të bëhem anëtarë?.....	12
Si mundem ti përkrah Asamblet rinore?.....	12



Hyrje

Ky dokument ju ofron informata themelore për asambljetë rinore. Çka janë asambljetë rinore, çfarë bëjmë, kush janë anëtarët dhe si mund të anëtarësoheni.

Gjithashtu këtu do të gjeni për rekomandimet tona për politika më të mira rinore në Kosovë dhe kontributet e dhëna përmes projekteve tona.

Nëse jeni një i ri, lexojeni këtë doracak dhe nëse ju rrëmben dhe dëshironi të inkuadroheni për të përmirësuar jetën, ejani dhe bashkohuni në asamblenë rinore. Këtë e bëjmë ne!

Nëse jeni zyrtarë lokal apo anëtarë i bashkësisë lokale, lexojeni, mendoni për të dhe na ndihmoni.

Çka është Asambleja Rinore?

Asambljetë rinore janë simulim joqeveritar dhe jopolitik i kuvendeve komunale në Kosovë. Këto Asamble përbëhen nga 20 deri 30 të rinj, të cilët merren me rikrijimin e aktiviteteve dhe funksioneve të kuvendit komunal. Kemi më shumë se 300 anëtarë nga komuniteti shqiptarë, serb, boshnjak, ashkali, romë, turk dhe kroat nga Kosova.

Ne takohemi për të diskutuar rreth çështjeve me interes për ne dhe për komunitetet tona, angazhohemi me përfaqësuesit e qeverisë lokale në këto çështje, trajnohemi në tema të ndryshme, krijojmë rekomandime për çështjet madhore për rininë në Kosovë (të radhitura në faqet e këtij doracaku) dhe pastaj zbatojnë projekte të cilat i drejtohen atyre çështjeve.

Kush mund të inkuadrohet?

Asambljetë rinore janë të hapura për të gjithë të rinjtë e moshave të shkollave të mesme. Asambljetë Rinore fillojnë të përzgjedhin pjesëmarrësit e interesuar në fillim të vitit por kjo procedurë vazhdon gjatë gjithë kohës. Kriter kryesor është që pjesëmarrësit të kanë angazhim dhe dëshirë të përmirësojnë komunitetin e tyre.

Ku gjenden asambljetë rinore?

Asambljetë Rinore janë themeluar në trembëdhjetë komuna në Kosovë. Asambljetë Rinore gjenden në:

Dragash - DR	Mitrovicë - MI
Gjilan - GN	Podujevë - PJ
Kaçanik - KA	Prishtinë - PR
Kamenicë - KK	Rahovec - RH
Leposaviq - LE	Prizren - PZ
Lipjan - LI	Suharekë
Vushtri - VU	

Ndryshimet e rekomanduara nga asambljetë rinore nga viti 2005

Kuvendet Rinore të Kosovës kanë identifikuar dhe janë pajtuar unanimisht për shtat problemet më të mëdha me të cilat rinia e Kosovës ballafaqohet sot.

Ato janë: papunësia, marrëdhëniet jo shumë të mira etnike, hapsira të pamjaftueshme për të rinjë, mungesë e konsultimit me rininë nga organet vendimmarrëse, standarde dhe mundësi të pakta arsimore, ndotja e ambientit dhe martesat e hershme.

Më poshtë i kemi shtjelluar problemet në më shumë detaje, duke përfshirë arsyet e tyre, pasojat dhe zgjidhet e mundshme për të përmirësuar situatën.

Papunësia

Çështja parësore dhe njëra ndër çështjet më alarmante me të cilat ballafaqohemi ne sot është mungesa e mundësive për punësim brenda Kosovës. Pa ndonjë mundësi për të gjetur një punë të rregullt, të vlefshme dhe legale, si zgjedhje na mbetin një numër i vogël i mundësive të dëshirueshme. Largimi nga Kosova për atë numër të vogël të rinjesh të cilët kanë fatin të dalin jashtë vendit dhe kryesisht angazhohen në punë fizike shërbyese, nëpërmjet të cilave aftësitë e tyre nuk vijnë në shprehje, kjo nxit aktivitete kriminale. Që të trija këto opsione kanë një ndikim të madh negativ për Kosovën në përgjithësi. Ne i kemi identifikuar 6 mënyra se si me shpenzime të vogla në mënyrë që të përmirësohet kjo situatë.



Një djalosh i pa-strehë në Prishtinë

◊ **Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me bizneset e Kosovës** duhet të bashkëpunojnë në mënyrë që të ofrojnë përvojë pune gjatë verës për të gjithë të interesuarit. Kjo do të sillte efekte të ndërsjella pozitive si për bizneset edhe për nxënësit. Bizneset do të kishin pasur mundësi që në mënyrën më të mirë ta prezantojnë punën e tyre si dhe mundësinë e punësimit të matutjeshëm për ata të cilët janë treguar të mirë gjatë punës. Kështu nxënësit do të kishin rast të përfitojnë përvojë pune adekuate dhe njëkohësisht do të kishin plotësuar njohuritë e tyre teorike/arsimore nga përvoja e fituar.

◊ **IPVQ dhe BE** do të duhej që ta përfshinin rininë e Kosovës në cili-ndo grup punues i cili synon të zgjedhë problemin e papunësisë në mënyrë që të sigurohen se brengat e rinisë janë të adresuara në mënyrë adekuate përmes propozimeve.

- ◇ **UNMIK-u dhe IPVQ-të** duhet ti ndryshojnë ligjet doganore me qëllim që të stimulohet/favorizohet prodhimi vendor më tepër se ai i importuar.
- ◇ **Zyret komunale të punësimit/Byrotë për punësim** duhet te ofrojnë trajnime në lëmitë sikurse që janë : përpilimi dhe shkruarja e CV-se(biografisë), teknikat e intervistimit, si të aplikohet për punë etj.
- ◇ **Bizneset e Kosovës** do të duhej t'i bënin shpalljet për punësim në botimet/revistat rinore.
- ◇ **SHPK dhe Gjykatat Komunale** duhet ti përcjellin rastet e shfrytëzimit të fëmijëve të cilët detyrohen të punojnë, si dhe të sigurojnë një tretman adekuat të punëtoreshave të rinjve në Kosovë.

Marrëdhëniet ndëretnike

Problemi i dytë me të cilin ballafaqohet rinia e Kosovës janë marrëdhëniet ndëretnike të cilat ende nuk qëndrojnë në nivelin e duhur. Kjo rrjedhë nga presioni direkt apo indirekt nga shoqëria në të cilën ende ekziston frika nga mënyra se si mund të reagoj familja, miqtë ose pjesëtarët të tjerë të shoqërisë në lirinë e lëvizjes apo shoqërimin eventual me pjesëtarët e bashkësive tjera. Bashkësitë minoritare i frikohen integritit në shoqëri për shkak se sulmi dhe dhuna kundër pjesëtarëve të bashkësive minoritare në Kosovë është ende e pranishme.

Sërish kemi bërë përpjekje të gjejmë 5 rekomandime që mund të ndihmojnë në tejkalimin e kësaj situatë.

- ◇ **IPVQ** në Kosovë duhet të sigurojnë kushte për hapjen e vendeve të përbashkëta të punës si rastin e Gjilanit ngase integrimi do të jetë shumë më i sukseshëm nëse ekziston interesi financiar në të dyja anët.
- ◇ **Asambletë rinore, UNMIK-u, dhe IPVQ-të** duhet të realizojnë shumë më tepër manifestime të përbashkëta kulturore dhe sportive me ndihmën e KFOR-it dhe të SHPK-së në rast nevojë.
- ◇ **Asambletë rinore, UNMIK-u, IPVQ-të me Mediat** duhet të organizojnë fushata informative për të përkrahur të gjithë ata të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në promovimin e bashkëjetesës dhe të bashkëpunimit.
- ◇ **Asambletë rinore dhe MASHT-i** duhet të bashkëpunojnë në organizimin e grupeve punuese nëpër shkollat të cilat do të diskutojnë në temën e marrëdhënieve ndëretnike dhe të inkuadrimin të zyrtarëve të komunës dhe politikanëve në ato bisedime.
- ◇ **Kuvendet rinore** do të marrin pjesë në organizimin e një karnavali që do të shërbej për të promovuar lëvizjen e lirë. Këto manifestime do të përcillen me muzikë dhe diskutime në tema të caktuara.

Mungesa e objekteve kulturore, sportive dhe rinore

Çështja e tretë që ne kemi identifikuar dhe që ka një ndikim të madh tek të rinjtë e Kosovës është mungesa e qendrave sportive, teatrove,

kinemave dhe lokacioneve për aktivitete të përgjithshme rinore. Kjo mungesë e shkarkimit të energjisë dhe e shprehjës së krijimtarisë të të rinjve sjell në rritjen e numrit të përdoruesve të drogës dhe alkoolit dhe të atyre që inkuadrohen në krime. Gjendja është e tillë për shkak të mungesës së bashkëpunimit në mes komunave me të rinjtë dhe të alokimit të buxhetit dhe lokacioneve që kërkohen për këto aktivitete.



◇ **IPVQ-të** mund të përsëris aktivitetin kulturor që ishte organizuar në Suharekë me emrin Festari nëpër gjithë Kosovën. Një festival një javor me aktivitete sportive dhe kulturore që është zbatuar nga fondet e komunës dhe të donatorëve.

◇ **IPVQ-të** duhet të inkuadroj rininë në planifikimin e buxhetit për aktivitetet rinore në nivelin komunal dhe qendrorë.

◇ **Asambletë rinore** mund të organizojnë aktivitete sportive dhe kulturore në bashkëpunim me Komunat.

◇ **Asambletë rinore** mund të organizojnë fushata për ngritjen e vetëdijes së të rinjve për efektet negative të drogës dhe alkoolit pas përdorimit të tyre.

Mungesa e inkuadrimit të të rinjëve në procesin e marrjes së vendimeve

Brenga yne e katërt është që të rinjtë e Kosovës janë lënë jashtë procesit të marrjes së vendimeve. Nuk ftohen në mënyrë të rregullt në diskutimet e rëndësishme që ndikojn në jetën dhe të ardhmën e tyre në shkolla, universitete, qeveri lokale dhe qendrore dhe në UNMIK. Kjo ka shkaktuar që të aprovohen ligjet dhe rregulloret të cilat janë dedikuar për të rinjtë mirëpo nuk kanë arritur qëllimin.

◇ **Asambletë rinore, OJQ-të rinore, forumet dhe grupet joformale rinore** mund të themelojnë dhe të organizojnë këshillat e nxënësve me qëllim të nxitjes dhe inkurajimit të nxënësve në proceset e marrjes së vendimeve nëpër shkolla dhe IPVQ. Të përpilojnë projekte dhe të grumbullojnë fonde për këto këshilla/forume me qëllim të sigurimit të funksionimit të tyre.

◇ **Asambleja rinore dhe Zyrtari Komunal për Informim** mund të organizojn fushata për vetëdijësim të të rinjëve me qëllim të njoftimit mbi ligjet dhe të drejtat e tyre.

◇ **OJQ-të rinore** – të organizojnë grupet punuese për të rinjë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre dhe vetëdijësimi mbi të drejtat e tyre brenda procesit vendim marrës.

◇ **IPVQ-të** duhet të inkurajojnë dhe të ndihmojnë në pjesëmarrjen e rinisë në përpilimin e buxhetit komunal dhe qëndror dhe përpilimin e politikave me qëllim të sigurimit të fondeve dhe burimeve të mjaftueshme për aktivitete rinore dhe zbatimin e legjislacionit që rregullon konsultimet paraprake me të rinjtë për këto çështje.

Më tej, komunat brenda strukturave të tyre duhet të themelojnë pikat kontaktuese për çështjet rinore (p.sh. Zyrëtari për çështje rinore-ZÇR) dhe të kërkohet nga ZÇR-ja përgaditja e planit vjetor veprues për përpilimin e çështjeve rinore në nivelin komunal. Ky plan veprues duhet të përpilohet në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e të gjitha grupeve rinore.

◇ **Ministria për Kulturë Rini dhe Sport (MKRS) dhe Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (MASHT)** duhet të ndërprejë praktikën e deritanishme të miratimit të vendimeve me ndikim në rininë pa pëlqimin paraprak nga ana e këshillave/forumeve të shkollave. Gjithashtu, organizimi i cilido aktivitet duhet të jetë në bashkëpunim me të rinjtë me qëllim të sigurimit të përshtatshmërisë së tyre me kohën dhe orarin e ditës së të rinjëve.

◇ **MKRS** duhet të sigurojë funksionimin e Parlamentit rinorë të Kosovës dhe që asambltetë rinore të marrin rolin aktiv në Parlamentin rinorë.

◇ **Bashkësia Ndërkombëtare** duhet të ndërmarrë hapa serioz në mënyrë që të ndikoj në IPVQ-të lokale dhe qendrore, që proaktivisht të merr parasysh dhe të përfshijnë rekomandimet dhe brengat e grupeve rinore. Ata gjithashtu duhet të sigurojnë bashkëpunimin në mes të rinisë dhe autoriteteve lokale gjatë zhvillimit dhe zbatimit të projekteve me ndikim tek të rinjtë.

Mungesë e çasjes në ambiente dhe institucione kualitative

Problemi i pestë të cilin e kemi identifikuar në është standardi i ulët i pajisjeve arsimore dhe vështirësia e çasjes në ato ekzistuese. Bibliotekat janë të varfëra, labororet janë të pamjaftueshme, mësimdhënësit nuk janë të motivuar si dhe numri i vendeve të lira në Universitet publik është i kufizuar. Këto standarde të ulëta ndikojnë në pamundësinë e studentëve që praktikisht të ushtrojnë njohuritë e tyre teorike si dhe ta zhvillojnë kuptimin e drejtë të tyre. Si e tillë, përgaditja e tyre për jetën në botën praktike është e kufizuar dhe e pamjaftueshme. Këto probleme janë shfaqur si pasojë e sistemit të politizuar arsimor ku bindjet politike të cilat nuk lidhen me arsimin bien ndesh me esencën e politikës arsimore, që shpie drejt implementimit jo të drejtë të ligjeve mbi arsimin në të gjitha nivelet.

◇ **IPVQ-të dhe UNMIK-u** mund të sigurojnë që ligji mbi arsimin të implementohet në mënyrë të mirëfilltë.

◇ **Mësimdhënësit** duhet të kenë më tepër liri për të specializuar në lëmitë e ekspertizës së tyre individuale dhe të ligjerojnë dhe japin mësim

mbi lëndët të cilat i kanë më për zemër.

◇ **Asamblëtë rinore** duhet aktivizuar këshillet e shkollave në institucionet e tyre përkatëse dhe ti inkurajojnë të njejtat në institucionet tjera.
 ◇ **OSBE-ja** mund të organizojë trajnime për nxënësit/ studentët dhe punonjësit e arsimit lidhur me ndikimin e korrupsionit, mitos dhe politizimit të sistemit arsimor.

◇ **MASHT (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë)** mund të ofrojë informata më të mira rreth regjistrimit në universitet publik si dhe ta bëjë procesin e bursimit më transparent me më pak nepotizëm (të familjarizuar) dhe më të lehtë për çasje për ata të cilët ju nevojitet me të vërtetë.

Dëmtimi i ambientit

Problemi i gjashtë nga problemet e identifikuar më të cilat përballet rrinia e Kosovës sot është gjendja e ambientit të dëmtuar e shkaktuar nga popullata indiferente/e pa interesuar, komuniteti i biznesit dhe institucionet. Me një mungesë të vetëdijes së popullsisë në përgjithësi lidhur me këtë çështje, kujdes të pakët të autoriteteve lokale dhe qendrore për të zgjidhur

problemin, investimet e pamjaftueshme në riciklimin dhe grumbullimin e mbeturinave, planifikimi i dobët për vendosjen e fabrikave dhe praktikave të shfrytëzimeve ilegale, bëjnë që e ardhmja e ambientit të Kosovës të duket e zbehtë. Jemi ne që duhet të ballafaqohemi me gabimet e gjeneratave më të vjetra dhe si të tilla ne kemi propozuar gjashtë mënyra për të përmirësuar situatën.



Një shembull i pakujdesisë ndaj ambientit në Kosovë

◇ **Asamblëtë rinore, OJQ-të, OSBE-ja, IPVQ-të dhe mediat** mund të udhëheqin fushata mediale (TV, Radio, fletushkave) dhe trajnime/diskutime në grupe lidhur me problemet e ambientit nga ana e eksperëve lokal, efektet e mundshme, çfarë fenomene natyrore do të mund të mbroheshin, mënyrat më të cilat njerëzit do të mund të ndihmonin dhe çfarë mund të arrihet. Me më tepër njohuri, ata mund të jenë pjesë e zgjidhjes dhe presionit mbi qeverinë për ndryshime.

◇ **MASHT-i** duhet të inkorporojë aspekte të arsimit për ambientin në kurikulin e shkollës fillore në mënyrë që njohuritë të rrënjosen që nga mosha e re. Prandaj, nuk do të ketë nevojë për ndryshim pikëpamjeje, por vetëm në formimin e tyre.

◇ **Asamblëtë rinore, OJQ-të dhe anëtarët e komunitetit lokal** mund të marrin pjesë në aksionet për pastrimin e zonave lokale me vlerë natyrore të dëmtuara nga shkarkimet ilegale dhe mbeturinat.

◇ **IPVQ-të dhe UNMIK-u** – të aprovojnë ligje dhe legjislacion që të

mbrojnë zonat e pakta të gjelbëruara që kanë mbetur dhe ambientin në përgjithësi. Mbrojtje shtesë për pyjet nga prerja ilegale dhe kërkesat për një vlerësim për ndikimin në ambient mbi të gjitha zhvillimet e mëdha industriale. Ky legjislacion do të ketë efekt shtesë në rritjen e vetëdijes dhe do të fuqizojë ata të cilët po mundohen t'i bëjnë ndryshimet.

Martelat e hershme

Çështja e shtatë e identifikuar, me të cilën rinia e Kosovës përballlet sot, është edhe martesa e hershme. Ndoshta është një problem që prek një numër të vogël, por efekti negative i saj është i tmerrshëm.

◇ **Policia dhe gjykatat komunale** duhet të mbështesin ligjet relevante që janë në fuqi në mënyrë që t'i mbrojnë të rinjtë nga abuzimi.

◇ **Qendrat për punë sociale dhe zyrtarët komunal për barazi gjinore** duhet të obligohen që t'i vizitojnë shkollat dhe në mënyrë të gjërë t'i informojnë të rinjtë lidhur me të drejtat e tyre ligjore, procedurat dhe mënyrat e ndihmave që janë në dispozicion për ata. Në anën tjetër këto institucione kanë nevojë për përkrahje nëpërmes ngritjes së kapaciteteve në mënyrë që të jenë të gatshëm të përgjigjen në mënyrë adekuate ndaj këtyre detyrave.

◇ **Asambletë rinore, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe drejtoritë komunale të arsimit (DKA)** duhet që ta diskutojnë këtë çështje nëpër shkolla dhe në media nëpër vendet ku është problemi i paraqitur dhe të ngritet vetëdija e popullatës për seriozitetin e kësaj çështjeje.

Trajnimet

Trajnimet janë një pjesë e rëndësishme e projektit të Asamblesë rinore. Ne kemi mundësi t'i zhvillojmë shkathtësitë dhe aftësitë tona përmes trajnimeve të ndryshme me qëllim që t'i kuptojmë dhe adresojmë më mirë problemet me të cilat sot ballafaqohemi. Kemi vijuar trajnimet e cekura më poshtë, të cilat na janë ofruar nga OSBE-ja dhe OJQ-të lokale.

- ◇ Teknikat e avokimit dhe lobimit
- ◇ Si të planifikohet dhe të zhvillohet një fushatë
- ◇ Ndërtimi i ekipit



Trajnim në Gjilan, Asambleja rinore

- ◇ Strukturat komunale
- ◇ Përpilimi dhe menaxhimi i projektit
- ◇ Menaxhimi dhe zgjidhja e konfliktit
- ◇ Komunikimi i brendshëm
- ◇ Zgjidhja e problemit
- ◇ Të drejtat e njeriut
- ◇ Gazetari

Projektet gjatë viteve 2004 dhe 2005

Me qëllim që ti adresojmë çështjet e identifikuara, ne kemi implementuar disa projekte në Kosovë.

Marrëdhëniet e tendosura ndër-etnike

Ne jemi në proces të zhvillimit të një filmi dokumentar mbi lirinë e lëvizjes në Kosovë. Për këtë qëllim ne kemi vijuar trajnimin nga një këshilltar I BBC-së nga Britania e Madhe dhe që gjashtë muaj jemi duke bërë xhirime në njëmbëdhjetë komuna të Kosovës. Këtë e bëjmë me qëllim që ta promovojmë lirinë e lëvizjes duke vërë në pah disa çështje thelbësore lidhur me këtë temë së bashku jemi duke punuar disa filma dokumentarë të shkurtër mbi disa prej projekteve të mëposhtme.

Ne gjithashtu kemi organizuar një sër fushatash që kanë pasur për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe tolerancës ndër-etnike. Këto fushata kanë përfshirë parada nëpër qytete të ndryshme, shfaqje të këngëve dhe valle popullore, aktivitete sportive, ekspozita si dhe një seri debatesh mbi çështjet e lirisë së lëvizjes në Kosovë dhe promovimit të tolerancës ndër-etnike. Fushatat janë implementuar në Lipjan, Vushtrri, Suharekë dhe Prizren.

Anëtarët e asambleve rinore nga Vushtrri dhe Mitrovica kanë kaluar nëpër trajnime të trajnerëve mbi strukturat dhe funksionet e kuvendeve komunale, përgatitjen e projekteve dhe ndërtimit të paqes. Këto trajnime tani janë përcjellë nga anëtarët e asambleve rinore tek moshatarët e tyre në shkolla nën mbikqyrjen e Caritas-it

Mungesa e hapësirave sportive, kulturore dhe rinore

Asambleja Rinore e Dragashit e ka promovuar turizmin nëpërmes të përpilimit të hartave dhe vendosjes së shtyllave informative/udhëzuese të zonave, fenomeneve/dukurive natyrore dhe të shtigjeve të rajonit të Gorës, me qëllim të orientimit sa më të mirë për njerëzit që udhëtojnë në këtë rajon.

Asambleja Rinore e Dragashit gjithashtu ka menaxhuar edhe ri-aftësimin e fushës shkollore në Dragash dhe ka organizuar një turnir mbarë kosovar basketbolli me pjesëmarrje të 80 të rinjëve, inaugurimit të kësaj fushe.

Ne poashtu po provojmë të ofrojmë aktivitete sportive me shpenzime të ulëta për rininë e Kosovës përmes krijimit të një shoqate të orientuesve të cilat deri më tani janë krijuar në Gjilan, Kamenicë dhe Podujevë dhe kanë inkuadruar më shumë se 100 të rinjë

Mungesa e inkuadrimit në procesin e vendimmarrjes

Asambletë rinore kanë organizuar një fushatë (dymbëdhjetë tryeza të

rrumbullakta, një seri radio spotes, një debat televiziv dhe shkruar) në mënyrë që të ngrisin vetëdijen mbi vështirësitë ekzistuese me inkudrimin e të rinjve në procesin e vendimmarrjes në shkolla dhe të ndikojnë në përmirësimin e arsimit në shkollat e mesme. Kjo ka ngjarë deri më tani në Gjilan, Kamenicë, Mitrovicë dhe Vushtrri.

Anëtarët e asambleve rinore kanë themeluar një buletin në shkollat e MI. Përgatiten nga nxënësit dhe mbulon çështjet e arsimit, aktivitetet e komunës dhe të të rinjve në mënyrë që të ngritet vetëdija mbi çështjet me interes në komunitetin shkollorë. Deri me tani kanë dalë XX numra që kanë qarkulluar tek XX nxënës të shkollave të mesme dhe akoma vazhdon të dalë I pavarur nga fondet e OSBE me përkrahjen nga fondi i shkollave dhe nga shitja e këtij buletini.

Përkeqësimi i ambientit

Kemi implementuar një seri prej tetë fushatash me theks në rëndësinë e vetëdijes ambientale përmes radio spoteve, tri debateve televizive, gjashtë debateve në shkollat e mesme, posterëve dhe buletineve. Për më tepër, kemi organizuar tetë ditë pastrimi në zona të ndryshme të Kosovës dhe kemi siguruar mbi 200 shporta për hedhurina për qendrat e qyteteve për të promovuar vazhdimisht vetëdijen ambientale. Këto janë implementuar në Gjilan, Kamenicë, Vushtrri, Leposaviq, Podujevë dhe Suharekë në partneritet me organizatat e tjera rinore, zyrtarët komunalë për rini dhe me kompanitë komunale të shërbimeve publike.

Martesat e hershme

Asambletë rinore kanë punuar në ngritjen vetëdijes së nxënësve të shkollave të mesme dhe të prindërve të tyre për problemin e martesave të hershme në komunën e Rahovecit përmes trajnimeve, debateve (një në TV dhe dy në radio), dhe prodhimit e shfaqjes së një filmi të shkurtë dokumentar.

Kampi veror i asambleve rinore

Në mes të datave 19 dhe 26 gusht 2005, në Zhablak të Malit të zi u organizua kampi i tretë vjetor i asambleve rinore.

Në kamp merrën pjesë mbi 250 anëtarë të asambleve rinore të moshës në 16 deri 20 vjeç nga komuniteti shqiptarë, serb, ashkali, boshnjak, kroat, romë, dhe turk.

Kampi ka pasur dy qëllime:

1. Të ofrojë një mundësi për të rinjtë nga pjesë dhe grupe të ndryshme etnike të Kosovës për të takuar njëri tjetrin dhe për të ndërtuar marrëdhënie përtej kufijve gjeografik dhe etnik në mënyrë që të shtohet bashkëpunimi në mes asambleve rinore dhe
2. Për të na dhënë një forum për të diskutuar problemet kryesore me të cilat ballafaqohet rinia e Kosovës dhe për të përgatitur rekomandimet e mësipërme.

Përmes aktiviteteve për ndërtimin e ekipit, janë ndërtuar marrëdhënie në mes anëtarëve të regjioneve dhe etnive të ndryshme. Ka qenë një sukses i madh me shoqërime të mira dhe janë krijuar marrëdhënie pune dhe siq tha një anëtarë i grupit "ne filluam kampin me shtrëngime dore por përfunduam kampin me përqafime me njëri tjetrin".

Si mund të bëhem anëtarë?

Nëse jeni në mes moshës 15 dhe 18 vjeç dhe dëshironi të dini më shumë, kontaktoni shumicën e anëtarëve lokal në listën kontaktuese në fund të kësaj broshure ose zyrën e OSBE-së në regjionin tuaj.

Si mund t'i përkrah asamblëtë rinore?

Nëse jeni një zyrtarë komunal, anëtarë i ndonjë OJQ-je ose jeni shërbyes civil i cili mund të kontribuoj në zhvillimin e vetëdijes politike dhe sociale të të rinjve dhe që jeni të gatshëm të dëgjoni brengat tona dhe idetë tona atëherë ne do të dëshironim të dëgjojmë nga ju. Ju mund të kontaktoni asamblëtë rinore përmes listës kontaktuese në fund të këtij doracak, duke kontaktuar shkollat lokale ose duke kontaktuar zyrat e OSBE-së në rajonin tuaj.

Ju faleminderit!

Ju faleminderit që e keni lexuar këtë broshurë. Shpresojmë të na kontaktoni në të ardhmen, qoftë si anëtarë, zyrtarë, ose thjeshtë si një i interesuar për të kontribuar për përmirësimin e jetës së të rinjve në Kosovë. Na ndihmoni neve për t'i ndihmuar vetës.

Lista kontaktuese

Dragash: +381 29 44 200 - Latif

Gjilan:
Jelena Vasic: jelena_vasic_db@yahoo.com
OSCE: +381 280 24 757 - Edmond

Kaçanik:
OSCE: +381 38 500 162: Jeton Lika

Kamenicë:
Community Centre Kamenica: cc_kamenica@yahoo.com
Arta Hoda: artushi15@hotmail.com
Bedri Krasniqi: bedri_2@hotmail.com
OSCE: +381 280 24 757 - Ljubo / Fatmir

Leposaviq:
Bojana: bojanalep@yahoo.com
OSCE +38 28 33 944 - Snežana

Lipjan:
li_youth_assembly@hotmail.com
OSCE: +381 38 581 844 - Pedrag / Berat

Mitrovicë:
Besart Hajrizi: besarth@hotmail.com
OSCE: +38 28 33 944 Shkendiza

Podujevë:
Fidan Rekalii: rekaliu96@hotmail.com
Kreshnik Hyseni: niku_kh@hotmail.com
OSCE: 381 38 500 162 - Elita

Prishtinë:
OSCE: 381 38 500 162 - Ismet

Prizren:
OSCE: +381 29 44 200 - Alev

Rahovec:
OSCE: + 381 29 76 501 - Art

Suharekë:
Fisni Shurdhaj: niki_llokumi9@hotmail.com
Besart Lumi: bes_senior@hotmail.com
OSCE: +381 29 44 200 – Salih/Kreshnik

Vushtri:
Beqir Lahu: Beqir_l@hotmail.com
OSCE: +38 28 33 944 - Sevdije

www.youthassemblies.com